

FJALA E DEPUTETES ZHENI GJERGJI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot jemi mbledhur në këtë seancë për të miratuar në parim buxhetin e vitit 2022, ndërkohë që gjatë këtyre ditëve kam dëgjuar në Komisionin e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale grupet e interesit, si: përfaqësuesit e shoqatës së tetraplegjikëve, të verbrit, përfaqësuesit e shoqatës së jetimeve, dialektikëve, pacientët e hemodializës, pra shqiptarët e vërtetë të zhytur në halle e të nëpërkëmbur nga qeveria e vet, e votuar pak muaj më parë. Çuditërisht si paturpësisht shifrat tuaja trumbetohen si një nga arritjet më të mëdha të kësaj kohe të vështirë që po jetojmë. Ju që e zhytët këtë popull në borxhe dhe që dhe këtë fakt na e shisni si arritje; ju që trumbetoni “shëndetësi falas” e ndërkohë i zbrazët xhepat e qytetarëve për të paguar për shërbimet shëndetësore, medikamentet, kujdesin mjekësor; ju që rritet çmimet e ushqimeve të shportës, çmimin e naftës, çmimin e gazit, çmimin e energjisë elektrike duke u justifikuar me krizën globale; ju që harroni ato që keni premtuar një vit më parë, sot vini kaq mendjemëdhenj e ironik e na thoni që ky buxhet është më i miri ndër vite. Ky buxhet, sikur pothuajse të gjithë buxhetet e mëparshme të qeverisë “Rama” është një buxhet populist të cilin qeveria fatkeqësisht pretendon ta përdorë për zgjedhjet e ardhshme lokale sesa është një buxhet zhvillimor e mbështetës për shqiptarët. Arsyeja kryesore, që gjendemi para një kolapsi ekonomik dhe social, është pikërisht mendësia e fasadave të deritanishme politike, paaftësia e tyre, varësia e tyre korruptive dhe gatishmëria e tyre për të punuar mbi të gjitha për interesat e tyre familjare dhe ortakëritë e miqve të tyre.

Fatkeqësisht këto praktika të deritanishme të qeverisë “Rama” në hartimin e buxheteve në këta 8 vjet, kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten mbështetja e grupeve klienteliste, realizimi i interesave të tyre dhe pastaj pritja e feedback-ut në formë të votave. Së pari, dua të ndalem në edukimin parauniversitar dhe vlerësimin e dijes si strategji kombëtare. Qeveria “Rama” në programin e saj që nga viti 2013 pretendoi se do ta konsideronte arsimin si një nga politikatat më të mira ekonomike dhe si një sistem thelbësor që garanton zhvillimin tërësor të vendit e të kapitalit njerëzor. Kështu që për këtë arsye vendosi si objektiv financimin publik të arsimit në nivel 5% të PBB-së, me qëllim që të sigurohet arsim cilësor për çdo fëmijë, pavarësisht origjinës, rrethanave familjare apo situatës ekonomike. Rritjen e financimit publik e kërkuan edhe studentet në protestat e vitit 2018.

a kërkuan rritje të buxhetit me 5% të GDP-së, me qëllim përgjysmimin e tarifës së studimit për çdo nivel studimi dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës në universitete. Po ç’ndodhi në të vërtetë? UNICEF-i në një raport, që vlerësonte strategjinë aktuale të arsimit parauniversitar për vitet 2014-2020, shprehej se Shqipëria është larg objektivit të vitit 2020 për shpenzimet publike prej 3% për arsimin parauniversitar dhe 5% për arsimin në tërësi. Niveli i buxhetit të disponueshëm, krahasuar me PBB-në, mbetet më i ulët sesa ai i synuar dhe Shqipëria është vazhdimisht një nga vendet me investimet më të ulëta kushtuar arsimit në rajon. Sipas një raporti të EUROSTAT-it për vendet e

BE-së raportohet se Shqipëria shpenzon fonde publike për arsimin më pak se të gjitha vendet e BE-së. Mesatarja e BE-së në vitin 2019 ishte 4,7% e PBB-së krahasuar me Shqipërinë që shpenzon fonde publike sa 2,56% të PBB-së për arsimin. Kjo mendësi e mbrapshtë na ka vendosur në situata shumë të vështira, sepse 183 mijë të rinj janë larguar nga vendi qysh nga viti 2014, sepse nuk panë dhe nuk po shohin asnjë perspektivë, asnjë të ardhme. Midis atyre, që janë larguar e po largohen çdo ditë nga Shqipëria, ka edhe shumë mjekë dhe personel mjekësor, të cilët, po të kishte treguar shteti më shumë interes dhe kujdes për ta, sot do t'i kishim këtu e nuk do të kishim mungesë të mjekëve dhe stafit mjekësor në menaxhimin e pandemisë.

Në sistemin shëndetësor mbeten përsëri qesharake shifrat e alokuara për vitin 2022 kur dihet që jemi përpara një situatë të vështirë të shkaktuar jo vetëm nga pandemia, por edhe keqmenaxhimi. Sipas "Western Balkans" Shqipëria financoi paketën më të ulët antikovid krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Rimbursimi i medikamenteve antikovid filloi në nëntor të 2020, 6 muaj me vonësë, janë dhënë 7500 receta të rimbursueshme për 183 mijë të infektuar me Covid deri në fund të tetorit. Po të tjerët? Mjeku i familjes, edhe pse u përfshi me vonësë në trajtimin e pacientëve me Covid, nuk pati mbështetjen e duhur logjistike dhe nuk u shpërblye si kolegët e tjerë që punonin me pacientët Covid, megjithëse ishin përpara të njëjtit rrezik. 100 maska i janë dhënë mjekut të familjes në Elbasan që nga marsi i vitit 2020. Shqiptarët ende vazhdojnë të jenë të pambrojtur nga efektet e Covid-it dhe për këtë mjafton të dëgjoje zërin e gjithë njerëzve që ditën e enjte u paraqitën pranë Komisionit të Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale. Pra, kjo mendësi ka dëmtuar shumë sfera të jetës jo vetëm shëndetësinë dhe arsimin, por kulturën dhe pa dyshim ka ndaluar zhvillimin ekonomik, gjë e cila mund të vërehet në shumë parametra ekonomike. Eurobondi, euforia juaj e radhës, nuk është gjë tjetër veç një instrument standard borxhi, që kurrsesi nuk ka si të jetë një histori suksesi në kushtet kur kërkohet për të shlyer një borxh ekzistues. Së dyti, dua të ndalem tek inceneratori i Elbasanit, afera e parë dhe më e madhe korruptive. Ndotja e mjedisit në qytetin e Elbasanit dhe veçanërisht e ajrit ka qenë dhe mbetet shqetësim i përhershëm i banorëve të këtij qyteti.

Referuar të gjitha statistikave të sotme Elbasani mbetet nga qytetet më të ndotura në Shqipëri. Ajo që flet më shumë janë dhe statistikave të sëmundjeve tumorale ku përsëri rezulton të ketë numër të madh pacientësh. Të babëzitur, të zhytur në krim, të pandërgjegjshëm e të papërgjegjshëm, siç jeni, vazhdoni të mbillni vdekjen në këtë qytet, ndërkohë që mbushni xhepat e oligarkëve. Ka nisur hetimi për firmat që shkaktojnë ndotjen e qytetit, që qysh nga viti 2017 është në gjendjen e emergjencës mjedisore. Po kush do ta hetojë këtë krim mjedisor? Drejtësia juaj e kapur nga krimi!? Prej ditësh kam denoncuar me foto e video ndotjen që po ndodh në qytet. Ejani në Elbasan rreth orës 10 të darkës dhe sa të hyni në qytet do të hasni retë e mëdha të tymit që mbështjellin qytetin tim. Por në fakt, deri kur të vini e ta shikoni të vërtetën Elbasani im do të vazhdojë të ndotet, të varfërohet. 16 629 familje jetojnë në kushtet e mjerueshme të ndihmës ekonomike. Elbasanasit vuajnë papunësinë, emigrimin e rinisë, auditoret që boshatisen, degët e universitetit që mbyllen për shkak të politikave tuaja. Elbasani përballet me numrin e shtuar të sëmundjeve tumorale, ndërkohë që miqtë e qeverisë dhe të Kryeministrit Rama, si Stela Gugallja me shokë pasurohen. Kjo me të vërtetë është për të ardhur keq dhe unë duke qenë pro qytetarëve dhe kundër vuajtjeve të tyre, do të jem kundër këtij projekt-buxheti.

Do të votoj kundër në emër të të rinjve elbasanas, që kanë studiuar në universitetet më të mira europiane dhe nuk dëshirojnë të kthehen në vendin e tyre, pasi nuk shohin e nuk gjejnë asnjë mbështetje. Do të votoj kundër, në emër të atyre të rinjve që braktisin Shqipërinë për një arsim më të mirë e cilësor. Do të votoj kundër, në emër të të gjithë pacientëve të mi që nuk gjejnë asnjë përkrahje sociale dhe ekonomike. Do të votoj kundër, në emër të pensionistëve që enden vetëm dyerve të

spitaleve, pasi fëmijët i kanë braktisur e i kanë jashtë shtetit, dhe ndihen të pambështetur nga shteti. Reflektoni që të mos e shkretoni këtë vend! Faleminderit!